



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 607/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.12.2020 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “*Florfarma*” shpk në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-76094-10-20-2020, me objekt Loti 1: “*Shërbim dezinfektimi i ambienteve të brendshme*”, me fond limit 4.470.639,10 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 09.11.2020, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruar.

Ankimues: “Alpen Pulito” sh.p.k.
Adresa: Lagjia nr.14, Rruga Tiranë-Shkozë, Durrës.

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqëndruar.
Adresa: Sheshi “Skënderbej”, nr.3, Tiranë.

Subjekte të interesuar: “Florfarma” sh.p.k.
Adresa: Rruga “Qazim Vathi”, Nr.72, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe*

Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1, të nenit 63, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21.10.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-76094-10-20-2020, me objekt Loti 1: “*Shërbim dezinfektimi i ambienteve të brendshme*”, me fond limit 4.470.639,10 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 09.11.2020, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruar.

II.2. Në datën 09.11.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë

19.11.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Florfarma” shpk	1.271.204,088 lekë	kualifikuar
2. “Metani” shpk	1.399.752,810 lekë	skualifikuar
3. “Alpen Pulito” shpk	2.321.018,700 lekë	kualifikuar
4. “Egian Med” shpk	2.398.147,940 lekë	skualifikuar
5. “NRG” shpk	2.428.142,640 lekë	kualifikuar
6. “Pastrime Silvio” shpk	2.499.558,600 lekë	kualifikuar
7. “Meldi” shpk	2.586.686,070 lekë	kualifikuar
8. “AIR” shpk	2.675.000,000 lekë	skualifikuar
9. “Xpert System shpk & Shpresa-al shpk”	2.713.806,480 lekë	skualifikuar
10. “Clean Fast” shpk	2.770.934,240 lekë	kualifikuar
11. “HOREAL Expo Group” shpk	3.570.798,000 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 19.11.2020, operatori ekonomik “Alpen Pulito” shpk është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit, si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë.

II.5. Operatori ekonomik “Alpen Pulito” shpk, në datën 20.11.2020 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së paraqitur prej shoqërisë “Florfarma” shpk, në këtë procedurë prokurimi, sipas pretendimeve si më poshtë vijon:

[...]

Shoqëria “ALPEN PULITO” shpk (këtu e në vijim OE ankimues) ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit me objekt “Loti 1 Shërbim dezinfektimi të ambienteve të brendshme”, të organizuar nga Autoritetit Kontraktor (këtu e në vijim AK) Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

Nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik (këtu e në vijim SPE) operatori ekonomik ankimues, më datë 19.11.2020 është njoftuar për kualifikimin dhe renditjen e operatorëve ekonomik të tjerë pjesmarrës si më poshtë:

FLORFARMA	1271204.09	kualifikuar
METANI	1399752.81	skualifikuar
ALPEN PULITO	2321018.70	kualifikuar
EGIAN MED	2398147.94	skualifikuar

Lehtësisht vërehet se oferta e paraqitur nga shoqëria e kualifikuar në vend të parë është një ofertë anomalisht e ulët në kuptim të ligjit e si rrjedhojë ky ofertues duhet skualifikuar.

Në nenin 56 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se “[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave,

i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementë të veçanta të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe;/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi; zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund të refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.”.

Në nenin 66, pika 5 të Vendimit nr.914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se: “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shume se 25% e fondit limit të përllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Në një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me provë shkresore sqarimet për elementin ose elementët e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.”.

Nga interpretimi literal i nenit 56, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, OE ankimues konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga vetë ligji dhe në zbatim të VKM 914/2014. Gjithashtu argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci, si edhe bindje autoritetit kontraktor.

Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve.

Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

Katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat me anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatori ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56, pika 2 të LPP-së, autoriteti kontraktor duhet ti verifikojë këto elemente në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor duhet të refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementët e saj.

Nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangjen e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët dhe në vlerësimin tonë kjo është një ofertë e paargumentueshme përse AK ka kërkuar në specifikimet teknike dhe përse ka ofertuar shoqëria "FLORFARMA".

Risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorët ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët.

Referuar nenit 1, gërma "b" "Objekti dhe qëllimi" i ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se "Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedural. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave pa të Meta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar "çmimit më të ulët"), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përllogaritjes të parashikuar në ligj).

Vërtet ligjvënësi ka lejuar paraqitjen e ofertave anomalisht të ulta, por në çdo rast operatorët ekonomikë duhet të paraqesin në çdo rast prova bindëse për autoritetin kontraktor se nuk ka asnjë rrezik për realizimin me sukses të kontratës me çmimin e ofertuar dhe se në këtë çmim janë të përfshira të gjithë elementët e koston të nevojshme dhe të detyrueshme për të mbuluar të cilat në rastin konkret nuk mund të provohen.

Në kuptim të ligjit për prokurimin publik dhe konkretisht nenit 56 të tij, në justifikimin e ofertave anomalisht të ulëta, operatorët ekonomike duhet të dëshmojnë se përmbushin 4 kushtet kumulative ku dy prej të cilave lidhen drejtpërdrejtë me metodën ekonomike të ndërtimit të ofertës së dorëzuar, si edhe kushtet favorizuese që kanë operatorët ekonomikë të cilat kanë lejuar këtë të fundit, të paraqesin një ofertë e cila është anomalisht e ulët sipas formulës së përcaktuar në Vendim të Këshillit të Ministrave.

Sa më sipër, në këto kushtet kur nga përllogaritja e ofertës ekonomike rezulton se vlera e saj është anomalisht e ulët dhe e pajustificuar kërkojmë skualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria "FLORFARMA".

II.5. Me anë të shkresës nr.2324/3 prot., datë 26.11.2020, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimes, duke e refuzuar atë me pretendimet si më poshtë:

Pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara është depozituar ankesa protokolluar me tonën me nr.2324 prot, datë 20.11.2020, nga ofertuesi “Alpen Pulito” SHPK, për vlerësimin e ofertës së paraqitur në procedurën e prokurimit, “Kërkesë për Propozim - Shërbime”- Marrëveshje Kuadër me afat 24 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër, me disa operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me objekt: “Shërbim Dezinfektimi”, e ndarë në 2 Lote, me fond të marrëveshjes kuadër: 5,060,684.21 lekë (pa TVSH), me nr. REF-76090-10-20-2020, me konkretisht: Loti I “Shërbim dezinfektimi i ambienteve të brendshme”, me fond të marrëveshjes kuadër: 4,470,639.10 lekë pa-TVSH, me nr. REF-76094-10-20-2020 me datë të mbylljes së vlerësimit 19.11.2020. Ankesa është paraqitur brenda 7 ditëve nga dita kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni mbi vlerësimin e ofertës. Me marrjen e ankesës me shkrim, Organi Qendror Blerës pezulloi vazhdimin e procedurës së prokurimit, deri në marrjen e vendimit përfundimtar sipas parashikimeve në nenin 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Në mbështetje të nenit 63, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 2, 3, 5: “Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita kur ankimesi është veçse në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”, si dhe të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, neni 78, pika 5: “Gjatë procedurës së prokurimit, ankesat kundër vendimeve të autoritetit kontraktor duhet të dorëzohen fillimisht pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga dita e nesërme punës, nga data kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për këtë shkelje të ligjit.”, pasi u shqyrtuan të gjitha dokumentat e vëna në dispozicion për këtë procedure prokurimi, ju komunikojmë vendimin si më poshtë:

1. Ofertuesi “Alpen Pulito” SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit “Florfarma” SHPK me pretendimin si vijon: [...] “Lehtësisht vërehet se oferta e paraqitur nga shoqëria e kualifikuar në vend të parë është një ofertë anormalisht e ulët në kuptim të ligjit e si rrjedhojë ky ofertues duhet skualifikuar... Në nenin 66, pika 5, të Vendimit nr.914, datë 29.12.2014 të Këshillit Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se: “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anormalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anormalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anormalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP. Oferta vlerësohet anormalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anormalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara

se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementët e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, OE ankimes konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonornik, oferta e të cilit është konstatuar nga vetë ligji dhe në zbatim të VKM 914/2014. Gjithashtu argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci, si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara, si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. Katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat me aneë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatori ekonomike, oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56, pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor duhet ti verifikojë këto elemente në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor duhet të refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementët e saj. Nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët dhe në vlerësimin tonë ajo është një ofertë e pa argumentueshme përse AK ka kërkuar - në specifikime teknike dhe përse ka ofertuar shoqëria “FLORFARMA”. Risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime kundër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonornik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore. Të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vinte nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Vërtet ligjvënësi ka lejuar paraqitjen e ofertave anomalisht të ulëta por në çdo rast operatorët ekonomikë duhet të paraqesin në çdo rast prova bindëse për autoritetin kontraktor se nuk ka asnjë rrezik për realizimin me sukses të kontratës me çmimin e ofertuar dhe se në këtë çmim janë të përfshira të gjithë elementët e koston të nevojshme dhe të detyrueshme për të mbuluar të cilat në rastin konkret

nuk mund të provohen. Në kuptim të ligjit për prokurimin publik dhe konkretisht nenit 56 të tij, në justifikimin e ofertave anomalisht të ulëta, operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se përmbushin 4 kushtet kumulative ku dy prej të cilave lidhen drejtpërdrejtë me metodën ekonomike të ndërtimit të ofertës së dorëzuar, si edhe kushtet favorizuese që kanë operatorët ekonomikë të cilat kanë lejuar këtë të fundit, të paraqesin një ofertë e cila është anomalisht e ulët sipas formulës së përcaktuar në Vendim të Këshillit të Ministrave. Sa më sipër, në këto kushtet kur nga përllogaritja e ofertës ekonomike rezulton se vlera e saj është anomalisht e ulët dhe e pajustificuar kërkojmë skualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria “Florfarma” shpk.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vlerësimin e bërë në sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, dokumentet e dorëzuara nga ofertuesi “Florfarma” shpk, pretendimet e parashtruara në ankesë mbi kualifikimin e ofertës së tij nga ofertuesi “Alpen Pulito” shpk konstatoi se:

Për ofertuesin “Alpen Pulito” shpk, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka njoftuar automatikisht nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik më datë 19.05.2020, kualifikimin e tij.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës ekonomike nga ofertuesi “Florfarma” shpk dhe konstatoi:

Në nenin 66, pika 5, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se: “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.”.

Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të ofertuesit “Florfarma” shpk, oferta ekonomike e paraqitur, në zbatim të nenit 66, pika 5, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, rezulton anomalisht e ulët.

Në pikat 1 dhe 2 të nenit 56, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon se: “1.Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementë të veçanta të ofertës, për:

a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;

b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;

c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;

ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.”.

“2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kushtet kumulative ku dy prej të cilave lidhen drejtpërdrejtë me metodën ekonomike të ndërtimit të ofertës së dorëzuar, si edhe kushtet favorizuese që kanë operatorët ekonomikë to cilat kanë lejuar këtë të fundit, të paraqesin një ofertë e cila është anomalisht e ulët sipas formulës së përcaktuar në Vendim të Këshillit të Ministrave.

Sa më sipër, në këto kushtet kur nga përlllogaritja e ofertës ekonomike rezulton se vlera e saj është anomalisht e ulët dhe e pajustificuar kërkojmë skualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria FLORFARMA “

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vlerësimin e bërë në sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, dokumentet e dorëzuara nga ofertuesi “Florfarma” shpk, pretendimet e parashtruara në ankesë mbi kualifikimin e ofertës së tij nga ofertuesi “Alpen Pulito” shpk konstatoi se:

Për ofertuesin “Alpen Pulito” shpk Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka njoftuar automatikisht nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik më datë 19.05.2020, kualifikimin e tij.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës ekonomike nga ofertuesi “Florfarma” shpk dhe konstatoi:

Në nenin 66, pika 5, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se: “Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Ne rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56, të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementët e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.”.

Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të ofertuesit “Florfarma” shpk, oferta ekonomike e paraqitur, në zbatim të nenit 66, pika 5, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, rezulton anomalisht e ulët.

Në pikat 1 dhe 2 të nenit 56, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se: “1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkates të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementë të veçanta të ofertës, për:

a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
 b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
 c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
 c) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.”.

“2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund të refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.”.

Në zbatim të nenit të sipërcituar më datën 13.11.2020 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, me anë të shkresës nr.2290 prot me objekt “Kërkesë për informacion mbi ofertën anomalisht të ulët”, i ka kërkuar ofertuesit “Florfarma” SHPK sqarim për ofertën ekonomike me vlerë 1,271,204,09 lekë (pa-TVSH) për procedurën e prokurimit Loti I, “Shërbim dezinfektimi i ambienteve të brendshme.”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kërkuar sqarimet si më poshtë vijon: se gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, është konstatuar se oferta e paraqitur, nga ana juaj, rezulton anomalisht e ulët. Përpara se të vazhdojmë me procesin e vlerësimit të ofertave, ju kërkohet të paraqisni me shkrim në rrugë elektronike dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementë të veçanta të ofertës tuaj, për:

a) anën ekonomike të procesit të prokurimit ose të shërbimeve të ofruara;
 b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ju keni për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
 c) origjinalitetin e mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ana juaj;
 ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.”.

Po ashtu, ju njoftojmë se keni detyrimin të argumentoni dhe të dokumentoni me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. Autoriteti kontraktor do t'i verifikojë këto elemente dhe në bazë të informacionit të paraqitur nga ana juaj, mund të pranojë ofertën ose mund të refuzojë atë, nëse pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur, nga ana juaj, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Në datën 16.11.2020 në sistemin elektronik të prokurimit, ofertuesi “Florfarma” SHPK brenda afatit kohor të përcaktuar, ka argumentuar ofertën anomalisht të ulët.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ana e ofertuesit rezulton se në përmbushje të parashikimeve të nenit 56 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, janë dorëzuar përshkrime narrative, si edhe dokumentacion shoqërues dhe provues mbi **argumentimin ligjor, teknik dhe ekonomik** të ofertës së dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, për procedurën e prokurimit objekt “Shërbim dezinfektimi i ambienteve të brendshme”.

Konkretisht, në lidhje me parashikimet e nenit 56, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ofertuesi “Florfarma” SHPK krahas sqarimeve për ofertën

anomalisht të ulët, ka bashkëngjitur edhe fature tatimore me objekt shitje “shërbim dezinfektimi” në të cilën vihet re vlera e ulët e çmimit të shitjes së këtij shërbimi.

Sa më sipër, është gjykuar se me anë të dokumentacionit të dorëzuar ofertuesi “Florfarma” SHPK përmbush katër kushtet kumulative të kërkuara nga ligji i posaçëm në drejtim të argumentimit të ofertës ekonomike anomalisht të ulët.

Për arsyet e mësipërme pretendimi i ofertuesit “Alpen Pulito” SHPK nuk pranohet.

II.6. Në datën 01.12.2020 operatori ekonomik “Alpen Pulito” shpk ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke parashtruar pretendime si më poshtë vijon:

Shoqëria “ALPEN PULITO” shpk (këtu e në vijim OE ankimues) ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit me objekt “Loti 1 Shërbim dezinfektimi të ambienteve të brendshme”, të organizuar nga Autoritetit Kontraktor (këtu e në vijim AK) Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

Nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik (këtu e në vijim SPE) operatori ekonomik ankimues, më datë 19.11.2020 është njoftuar për kualifikimin dhe renditjen e operatorëve ekonomik të tjerë pjesmarrës si më poshtë:

FLORFARMA	1271204.09	kualifikuar
METANI	1399752.81	skualifikuar
ALPEN PULITO	2321018.70	kualifikuar
EGIAN MED	2398147.94	skualifikuar

Lehtësisht vërehet se oferta e paraqitur nga shoqëria e kualifikuar në vend të parë është një ofertë anomalisht e ulët në kuptim të ligjit e si rrjedhojë ky ofertues duhet skualifikuar.

Fillimisht operatori ekonomik ankimues ka ezauruar ankimin administrativ pranë AK-së me anë të ankesës me shkrim depozituar pranë AK-së datë 20.11.2020.

AK me anë të vendimit nr.2324/2 prot, datë 26.11.2020 vendosi”

- Rrëzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues.

Në nenin 56 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se “[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementë të veçanta të ofertës, për:

a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbirneve të ofruara;

b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe;/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;

c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi; zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund të refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.”. Në nenin 66, pika 5 të Vendimit nr.914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se: “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Në një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me provë shkresore sqarimet për elementin ose elementët e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.”.

Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, OE ankimues konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga vetë ligji dhe në zbatim të VKM 914/2014. Gjithashtu argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci, si edhe bindje autoritetit kontraktor.

Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve.

Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

Katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat me anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatori ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56, pika 2 të LPP-së, autoriteti kontraktor duhet ti verifikojë këto elemente në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor duhet të refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementët e saj.

Nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangjen e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët dhe në vlerësimin tonë kjo është një ofertë e paargumentueshme përse AK ka kërkuar në specifikimet teknike dhe përse ka ofertuar shoqëria “Florfarma” shpk. Konkretisht çmujmë se nga ana e operatorit ekonomik “Florfarma” shpk nuk është argumentuar :

- 1- Kosto e detajuar e shpenzimeve lidhur me dezinfektimin për metër katror.
- 2- Nuk është përlllogaritur kosto e transportit e stafit dhe pajisjeve për kryerjen e shërbimit e shoqëruar me dokumentacion provues në raport me shpeshtësinë e kryerjes së shërbimit.
- 3- Kosto e personelit ku përfshihen 3 punëtor dhe 1 drejtues Teknik.
- 4- Sasia e materialit për secilin material të kërkuar nga AK në Shtojcën 8 "Specifikimet Teknike" që do të përdoret gjatë këtij shërbimi.
- 5- Vlera e amortizimit.

6- Kosto e pajisjeve të stafit përkatës si: (maskë, syze, çizme, doreza, kapuç, veshje mbrojtëse specifike që mbulon gjithë pjesët e trupit, etj) të cilat kërkojnë në Termat e Referencës.

Risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorët ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët.

Referuar nenit 1, gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedural. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave me ëto Meta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj).

Vërtet ligjvënësi ka lejuar paraqitjen e ofertave anomalisht të ulta por në çdo rast operatorët ekonomikë duhet të paraqesin në çdo rast prova bindëse për autoritetin kontraktor se nuk ka asnjë rrezik për realizimin me sukses të kontratës me çmimin e ofertuar dhe se në këtë çmim janë të përfshira të gjithë elementët e koston të nevojshme dhe të detyrueshme për të mbuluar të cilat në rastin konkret nuk mund të provohen.

Në kuptim të ligjit për prokurimin publik dhe konkretisht nenit 56 të tij, në justifikimin e ofertave anomalisht të ulëta, operatorët ekonomike duhet të dëshmojnë se përmbushin 4 kushtet kumulative ku dy prej të cilave lidhen drejtpërdrejtë me metodën ekonomike të ndërtimit të ofertës së dorëzuar, si edhe kushtet favorizuese që kanë operatorët ekonomikë të cilat kanë lejuar këtë të fundit, të paraqesin një ofertë e cila është anomalisht e ulët sipas formulës së përcaktuar në Vendim të Këshillit të Ministrave.

Sa më sipër, në këto kushtet kur nga përlllogaritja e ofertës ekonomike rezulton se vlera e saj është anomalisht e ulët dhe e pajustificuar kërkojmë skualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria “Florfarma” shpk.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 2424/1 prot., datë 15.12.2020, protokolluar me tonën në datën 17.12.2020 me objekt *“Dërgim dokumentacioni”* është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues *“Alpen Pulito” sh.p.k* për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së shoqërisë *“Florfarma” shpk* me arsyetimin se: *“Konkretisht çmimet se nga ana e operatorit ekonomik “FLORFARMA” shpk nuk është argumentuar:*

- 1- Kosto e detajuar e shpenzimeve lidhur me dezinfektimin për metër katror.*
- 2- Nuk është përlllogaritur kosto e transportit e stafit dhe pajisjeve për kryerjen e shërbimit e shoqëruar me dokumentacion provues në raport me shpeshtësinë e kryerjes së shërbimit.*
- 3- Kosto e personelit ku përfshihen 3 punëtor dhe 1 drejtues Teknik.*
- 4- Sasia e materialit për secilin material të kërkuar nga AK në Shtojcën 8 “Specifikimet Teknike” që do të përdoret gjatë këtij shërbimi.*
- 5- Vlera e amortizimit.*

6- Kosto e pajisjeve të stafit përkatës si: (maskë, syze, çizme, doreza, kapuç, veshje mbrojtëse specifike që mbulon gjithë pjesët e trupit, etj) të cilat ërkohen në Termat e Referencës.

Risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorët ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët.

Referuar nenit 1, gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedural. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave me të Meta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e

kontratës që mund të vijë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përllogaritjes të parashikuar në ligj).

Vërtetë ligjvënësi ka lejuar paraqitjen e ofertave anomalisht të ulta por në çdo rast operatorët ekonomikë duhet të paraqesin në çdo rast prova bindëse për autoritetin kontraktor se nuk ka asnjë rrezik për realizimin me sukses të kontratës me çmimin e ofertuar dhe se në këtë çmim janë të përfshira të gjithë elementët e kostos të nevojshme dhe të detyrueshme për të mbuluar të cilat në rastin konkret nuk mund të provohen.

Në kuptim të ligjit për prokurimin publik dhe konkretisht nenit 56 të tij, në justifikimin e ofertave anomalisht të ulëta, operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se përmbushin 4 kushtet kumulative ku dy prej të cilave lidhen drejtpërdrejtë me metodën ekonomike të ndërtimit të ofertës së dorëzuar, si edhe kushtet favorizuese që kanë operatorët ekonomikë të cilat kanë lejuar këtë të fundit, të paraqesin një ofertë e cila është anomalisht e ulët sipas formulës së përcaktuar në Vendim të Këshillit të Ministrave.

Sa më sipër, në këto kushtet kur nga përllogaritja e ofertës ekonomike rezulton se vlera e saj është anomalisht e ulët dhe e pajustifikuar kërkojmë skualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria “FLORFARMA”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar materialeve të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 2424/1 prot., datë 15.12.2020, rezulton se në datën 16.11.2020 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë autoritetit kontraktor me anë të shkresës nr.2290 prot, me objekt “Kërkesë për informacion mbi ofertën anomalisht të ulët”, i ka kërkuar operatorit ekonomik “Florfarma” shpk sqarim për ofertën ekonomike me vlerë 1.271.204,09 lekë. Referuar aktit të mësipërm ndër të tjera Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kërkuar sqarimet si më poshtë vijon: “... ju njoftojmë, se gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, nga anetarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, është konstatuar se oferta e paraqitur, nga ana juaj, rezulton anomalisht e ulët.

Përpara se të vazhdojmë me procesin e vlerësimit të ofertave, ju kërkojmë të paraqisni me shkrim / në rrugë elektronike dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementë të veçanta të ofertës tuaj, për:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ju keni për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ana juaj;
- 9) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

Po ashtu, ju njoftojmë se keni detyrimin të argumentoni dhe të dokumentoni me prova shkresore sqarimet për elementin/elementët e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Autoriteti kontraktor do t'i verifikojë këto elemente dhe në bazë të informacionit të paraqitur nga ana juaj, mund të pranojë ofertën ose mund të refuzojë atë, nëse pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur, nga ana juaj, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Për shpejtësi veprimesh kërkesa ju dërgohet edhe në formë elektronike në www.app.gov.al.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin,”.

III.1.2. Referuar materialeve të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 2424/1 prot, datë 15.12.2020, rezulton se në datën 16.11.2020 operatori ekonomik “Florfarma” shpk ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor përgjigjen për kërkesën anomalisht të ulët.

III.1.3. Referuar shkresës së mësipërme, operatori ekonomik “Florfarma” shpk ka argumentuar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon: “Bazuar në kërkesën tuaj në datë 16.11.2020, drejtuar elektronik nëpërmjet faqes APP, nga ana e institucionit tuaj, në lidhje me procedurën e prokurimit kërkesë për propozime me objekt “Shërbim Dezinfektimi”, me fond të përgjithshëm: 5,060,684.21 (pesë milion e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër pikë njezët e një) lekë, pa TVSH, nëpërmjet marrëveshjes kuadër, kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara, numri i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të përfundojë Marrëveshja Kuadër: 1 (një), për secilin lot, afati i marrëveshjes kuadër: 24 muaj, me REF-76090-10-20-2020, i ndarë në 2 (dy) lote, e zhvilluar më datë 09.11.2020, ora 12.00, Loti 1 “Shërbim dezinfektimi i ambienteve të brendshme”, me fond limit: 4,470,639.10 (katër milion e katërqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë pikë dhjetë) lekë, pa-TVSH; REF-76094-10-20-2020. Ku oferta jonë ka rezultuar anomalisht e ulët.

Ju sqarojmë motivet e kësaj oferte si më poshtë:

1. Shoqëria “Florfarma” sh.p.k, ushtron aktivitetin e saj në fushën farmaceutike prej vitit 1992 duke listuar në objektin e aktivitetit, import-export barna dhe materiale mjekimi, prodhim barna dhe dezinfektantë, kryerje të shërbimit 3D, distribucion dhe marketing të produkteve që disponon. Si prodhues dezinfektantësh, kosto e shërbimit të dezinfektimit, të kërkuar në këtë procedurë, ofertohet dhe mundësohet me një çmim më të ulët bazuar me konkurrencën e cila e kryen këtë shërbim me produktet e importit.

2. Produktet tona prodhohen nga lëndë të para të importuara nga Italia, kompani prodhuese e konsideruar më e madhja në Europë për lëndët aktive të barnave dhe dezinfektanteve.

3. “Florfarma” sh.p.k, si i vetmi prodhues vendas i cili ofron shërbimin 3D duke u nisur në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe situatës së vështirë që vendi ynë po kalon, vlerëson të arsyeshme të ofertojë në kosto, duke reduktuar shpenzimet.

4. Stafi i certifikuar i shoqërisë dhe i lartë në numër është i mjaftueshëm përkryerjen e këtij shërbimi në një afat kohor të reduktuar duke ulur shpenzimet.

5. Florfarma Sh.P.K nga eksperiencia të ngjashme, në procedura me të njëjtin objekt prokurimi të organizuara po këtë vit në të cilat ëshëte shpallur fitues, të realizuara me sukses oferton në këtë procedurë një ofertë me vlerë të reduktuar si pasojë e reduktimit të kostove të transportit duke qënë se vendi i kryerjes së shërbimit në këtë procedurë është Tiranë.

Gjithashtu ju informojmë se shoqëria “Florfarma” sh.p.k ka një eksperiencë shumë vjeçare në këtë procedurë dezinfektimi dhe ne si shoqëri kemi ofruar shërbimin tonë në sektorin publik dhe atë privat me përgjegjësi dhe korrektësi maksimale.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin shpresojmë të merrni në konsideratë ofertën tonë!

Mbetemi në dispozicion për çdo informacion të kërkuar.

Me respekt.”.

1- Faturë tatimore shitje elektronike nr. Serial 267819718, datë 16.09.2020, me shitës shoqërinë “Florfarma” shpk dhe blerës autoritetin kontraktor Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësie,

Tiranë, me objekt: “Shërbim dezinfektimi paketa D1”, me vlerë totale 2.608.537 lekë pa-TVSH, ku vlera e shërbimit për njësi është 13.5 lekë për njësi.

III.1.4. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se: “[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për: a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara; b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve; c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi; ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. 2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. [...]”.

III.1.5. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se: “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...]”

III.1.6. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Florfarma” shpk, si edhe nga përlllogaritjet e kryera Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se oferta ekonomike në vlerën prej 1.271.204,088 lekë pa TVSH, në zbatim të nenit 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, rezulton anomalisht e ulët. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor ka vepruar drejt kur gjatë periudhës së vlerësimit të ofertave i ka kërkuar informacion të detajuar operatorit ekonomik “Florfarma” shpk në zbatim të nenit 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

III.1.7. Nga interpretimi literal i nenit 56, pika 1, të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se barra e provës mbi argumentin e

ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar si e tillë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të aktit normativ në zbatim të ligjit VKM 914/2014. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjen teknike të ofruara, si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi, duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin si dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P. gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët, është në disa drejtime, ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik, oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore, të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërkimit të operatorit ekonomik ankimues, K.P.P. gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin të katër kushtet kumulative të parashikuara nga neni 56 i LPP-së.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, KPP gjykon se nga ana e operatorit ekonomik “Florfarma” shpk në përmbushje të parashikimeve të nenit 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, janë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor përshkrime narrative, si edhe fatura tatimore e shitjes nr.serial 267819718, datë 16.09.2020 për procedurën e prokurimit objekt ankimi. Konkretisht, në lidhje me parashikimet e nenit 56 pika 1 gërma “a” të ligjit

nr.9643/2006 në drejtim të argumentimit të anës ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të të shërbimit të ofruara, si një prej 4 kushteve kumulative, operatori ekonomik “Florfarma” shpk nuk ka dorëzuar një përshkrim të detajuar të kostos në të cilën ka përshkruar kostot e dizinfektantit, koston e puntorisë, koston e paisjeve dhe shpenzimet administrative, sipas termave të referencës të shërbimit të kërkuar në Shtojcën 11 të dokumentave të tenderit. Në lidhje me parashikimet e nenit 56 pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643/2006 në drejtim të argumentimit të zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;, si një prej 4 kushteve kumulative, operatori ekonomik “Florfarma” shpk ka deklaruar se është prodhues i produkteve që përdoren për dezinfektim dhe se lëndët e para i importon nga kompanitë italiane, ndërkohë që referuar licensës së dorëzuar në ofertë me nr. LN-2599-01-2017 të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit konstatohet se nuk është prodhues i lëndëve dezinfektuese, por i barnave për njerëz ose kafshë, si dhe nuk ka dorëzuar asnjë faturë blerje apo deklarata doganore importi të lëndëve të para për të provuar çmimin e shërbimit të ofruar në rolin e prodhuesit. Akoma më tej, KPP konstaton se operatori ekonomik “Florfarma” shpk njëherazi nuk ka provuar para autoritetit kontraktor eskperiencën e tij të ngjashme lidhur me çmimin e ofruar në ofertën anomalisht të ulët, pasi ky operator ka dorëzuar vetëm një faturë tatimore shitjeje e cila është e ngjashme me shërbimin objekt prokurimi, por konstatohet se çmimi për njësi i këtij shërbimi është 13.5 lekë për njësi, ndërkohë që çmimi i ofruar nga ana e e këtij operatori në ofertën e datës 19.11.2020, e cila ka rezultuar anomalisht e ulët është 8.9 lekë për metër katror, duke mos argumentuar çmimin e ofertës anomalisht të ulët, pasi çmimi i deklaruar në argumentim është më i lartë se çmimi i ofruar në ofertën anomalisht të ulët.

Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se me anë të dokumentacionit të dorëzuar shoqëria “Florfarma” shpk nuk përmbush katër kushtet kumulative të kërkuar nga ligji i posaçëm në drejtim të argumentimit të ofertës ekonomike anomalisht të ulët. KPP riktheson se, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, i cili duhet të japë analiza sa më të sakta dhe të shoqëruara me dokumenta provuese. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacionin në fuqi ka dalë anomalisht e ulët, nuk janë paraqitur sqarime për shërbimin e ofruar në kuptim të nenit 56 të LPP-së, të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Rrjedhimisht, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nga ana e operatorit ekonomik “Florfarma” shpk nuk është sjellë argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në respekt të nenit 56 të LPP-së, pasi nuk ka sjellë argumentim çmimi për të gjithë artikujt pjesë e ofertës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Alpen Pulito” sh.p.k qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të

Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Alpen Pulito” shpk për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-76094-10-20-2020, me objekt Loti 1: “*Shërbim dezinfektimi i ambienteve të brendshme*”, me fond limit 4.470.639,10 lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 09.11.2020, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruar.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatori ekonomik “*Florfarma*” shpk, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Alpen Pulito*” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 1594 Protokolli; Datë 01.12.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri